



V E N D I M

K.P.P. 74/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-39998-01-09-2018 me objekt: “Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private», me fond limit 1.929.605,52 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.01.2018 nga autoriteti kontraktor Tregu i Shitjes me Shumice Fruta - Perime Korçë.”

Ankimues:

“Dea Security” sh.p.k
Rr. “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I-rë, Tiranë,

Autoriteti kontraktor:

Tregu i Shitjes me Shumice Fruta - Perime Korçë,
ish UMB Korçë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar nën 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.01.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-39998-01-09-2018 me objekt: “*Ruajtja e godinave të Sh-A T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private*», me fond limit 1.929.605,52 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.01.2018 nga autoriteti kontraktor Tregu i Shitjes me Shumice Fruta - Perime Korçë.

II.2. Në datën 15.01.2018 operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm.

II.3. Në datën 17.01.2018, nëpërmjet shkresës nr. 7 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën.

II.4. Në datën 23.01.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar si vijon:

Së pari, në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar fondin 1.929.605,52 lekë pa tvsh. Fondi limit për një vendroje në muaj është 6.347,38 lekë pa tvsh.

Sa më sipër shihet qartë që fondi limit i përcaktuar nga autoriteti është i pamjaftueshëm për mbulimin e shërbimit të kërkuar pasi nuk përmbush as detyrimin për pagë minimale dhe shtesa turni pa përfshirë këtu shpenzimet e tjera të detyrueshme ligjore. AK në përgjigje është shprehur për numrin e rojeve 3.7.

Së dyti, në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin “nga data 03.03.2018 deri në datën 31.12.2018 për 304 ditë”, ndërkohë tek shtojca 11 “Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhje s së kontratës 10 muaj”. Pra në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka dhënë dy afate të ndryshme; një herë 10 muaj që i takojnë 306 ditë, dhe njëherë 304 ditë.

Kërkojmë nga autoriteti kontraktor të saktësojë afatin e dhënë në dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. AK në përgjigje është shprehur për 304 ditë.

Së treti, në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar tek shtojca 1 se bashkëngjitur formularit të cmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje në 2 vendroje në muaj, sipas tabelës së mëposhtme, ndërkohë tek shtojca 9, autoriteti kontraktor përcakton se: 1. Shërbimi do të kryhet me një vendroje nga hënë-premte (në ditë pune) ora 15:00-07:00, ditët e pushimit dhe festa zyrtare 24 orë me 4 punonjës shërbimi.

Kërkojmë të saktësohet numri i vendrojeve dhe numri i rojeve në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Autoriteti kontraktor në përgjigje është shprehur për një vendroje.

Së katërti, kërkojmë të hiqet kriteri: “Autoriteti kontraktor para se të nxjerrë vlerësimin, do të bëjë verifikimin e Qendrës së Kontrollit, sipas elementëve përbërës të Udhëzimit MB nr. 157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, për cdo operator ekonomik pjesëmarrës në tender. Mungesa e njërit prej tyre është kusht skualifikues.”

Kërkojmë të hiqet kriteri pasi për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për më tepër për funksionimin e qendrës së kontrollit, ka një organ përgjegjës që është Drejtoria Vendore e Policisë Korçë e cila gëzon të gjitha kapacitetet dhe aftësitë për të vlerësuar përmbushjen e dispozitave ligjore dhe jo autoriteti kontraktor. Autoriteti mund të kërkojë dokument të përcaktuar specifikisht që lëshohet nga DVP e cila certifikon qendrën e kontrollit të SHPSF, duke e pasqyruar atë në vërtetimin e performancës dhe aktin e miratimit të shoqërisë [...].

Së pesti, autoriteti kontraktor ka kërkuar tek kapaciteti ekonomik e financiar: “Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifën vendore për vitin 2014, 2015, 2016 për cdo vend të ushtrimit të aktivitetit për Nipt dytësor. Duke qenë se taksat vendore paguhen në fillim të vitit, nga ana e autoritetit kontraktor duhet të kërkojnë vitet 2015, 2016, 2017 dhe jo viti 2014, i cili duke qenë se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operativitetit për përmbushjen me sukses të kontratës, në rastin konkret e bën këtë një kriter të ekzagjuar dhe joproporcional me natyrën, objektin dhe përmasat e kontratës së shërbimit në fjalë, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi [...].

Së gjashti, autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë akt pronësie/kontratë qiraje për qendrën e kontrollit/sallës operative. Kontrata e qirasë të jetë me afat jo më pak se 12 muaj nga data e hapjes së ofertave.”

Kërkojmë nga AK të heqë këtë kriter pasi [...] nuk i shërben autoritetit kontraktor për verifikimin e kapacitetit teknik për qendrën e kontrollit, [...] është një kriter diskriminues, në kundërshtim me frymën e LPP-së.

Së shtati, autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim përformance, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë....Numrin e punonjësve të pajisur me autorizim për mbajtje arme jo më pak se 4.” Kërkojmë heqjen e kërkesës për autorizim për mbajtje arme jo më pak se 4 pasi [...] legjislacioni n ë fuqi për armët lejon dhe i jep të drejtën e blerjes së armës cdo personi fizik apo juridik përfshirë këtu edhe cdo operator ekonomik [...].

Së teti, Autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Akt miratimi për qendrën e kontrollit të ShPSF (24 orëshe) konform ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, shoqëruar me procesverbalin e miratimit.

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri pasi [...] kërkesa për qendër kontrolli duhet të konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e Akt miratimit të saj nga Drejtoria e Policisë së Qarkut. Autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin “shoqëruar me procesverbal”.

Së nënti, Autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Faturën e magazinës SIMA (Sistemi i Informatizuar i Menaxhimit të Armëve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë”.

Kërkojmë heqjen e kriterëve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen, janë diskriminuese dhe bien në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi, sipas legjislacionit për armët për të treguar pronësinë e armëve është e mjaftueshme paraqitja e autorizimit për blerje arme nga policia, kontratë blerje dhe faturat tatimore. Gjithashtu sqarojmë se faturën e SIMA e lëshon Drejtoria e Policisë Tiranë dhe më pas bëhet shpërndarja e armëve të regjistruara në DVP përkatëse. Pra kërkesa për faturën e magazinës SIMA të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë është diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.”

II.5. Në datën 29.01.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 97/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 12 prot., datë 26.01.2018, me objekt: “Dërgim informacioni me objekt: “Ruajtja e godinave të SH.A TSHFP Korçë dhe ambienteve brenda murit të saj rrethues.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit se: “Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar fondin 1.929.605,52 lekë pa tvsh. Fondi limit për një vendroje në muaj është 6.347,38 lekë pa tvsh.

Sa më sipër shihet qartë që fondi limit i përcaktuar nga autoriteti është i pamjaftueshëm për mbulimin e shërbimit të kërkuar pasi nuk përmbush as detyrimin për pagë minimale dhe shtesa turni pa përfshirë këtu shpenzimet e tjera të detyrueshme ligjore. AK në përgjigje është shprehur për numrin e rojeve 3.7”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, lidhur me këtë pretendim ankimuesi është shprehur:

“Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar fondin 1.929.605,52 lekë pa tvsh. Fondi limit për një vendroje në muaj është 6.347,38 lekë pa tvsh. Kërkojmë nga AK përlllogaritjen e fondit limit pasi fondi limit i përcaktuar nga ana e AK është i pamjaftueshëm, referuar dispozitave ligjore, pasi autoriteti kontraktor ka përcaktuar fondin limit në vlerën 1.929.605,52 lekë pa tvsh: 10 muaj : 4 roje =48.240,13 lekë/roje dhe fondi për një vendroje/një muaj-6.347,38 lekë është jo i njëjtë me fondin total.

III.1.2. Në Njoftimin e kontratës, Seksioni 2 “Objekti i kontratës”, pika 2.2 “Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër”, të dokumentave të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 10.01.2018, thuhet:

1. Fondi i Marrëveshjes Kuader per nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite, 1,929.605,52 (njemilion e nenteqind e njezeteente mije e gjashteqind e pese mije e pesedjet e dy) lekë pa TVSH.
2. Fondi limit per nje vendroje/nje muaj - 6.347,38 (gjashtemije e treqind e dyzet e shtate leke e tridhjetë e tete lekë pa TVSH
3. Burimi i Financimit : Të ardhurat e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe
4. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambienteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite.

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në datën 10.01.2018 nga autoriteti kontraktor, është parashikuar:

- 1.[...] Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me licensat, uniformat, paisjen me arme dhe radiomarres, pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 2 vend-roje në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos mujore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj
1	Shpenzime për pagë bazë	
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	
5	Tarifa për taksë armëmbajtje, municione, mirëmbajtje armatimi, etj.sipas akteve nenligjore	
6	Shpenzime për uniformë dhe veshëmbathje	
7	Shpenzime për ndërlidhje	
8	Shpenzime të tjera (administrative, etj.)	
9	Fitimi (%)	
	Vlera totale pa tvsh per 1 muaj	
	Vlera totale me tvsh per 1 muaj	

- Operatores janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vendroje të llogaritet (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**. Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Dite mesatare në muaj (për efekt të llogaritjes së ofertes) **30.41 ditë/muaj**
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore, kostot e armatimit, mirëmbajtjes, municionit, etj.), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Llogaritja e zerave të mos kalojë dy shifrat pas presjes dhjetore.

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit

III.1.3. Në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 10.01.2018, është parashikuar:

"Shërbimi në dy vendroje në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata.

- Nga dita e hënë deri të premte - orari i shërbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).
- Të shtunë - orari i shërbimit 24 ore
- Ditën e diel orari i shërbimit 24 ore
- Dite festa zyrtare orari i shërbimit 24 ore
- -Turni i dytë nga ora 19.00 – 22.00
- -Turni i tretë nga ora 22.00- 6.00 (ditë e nesërme)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve[...].

Objekti që do të ruhet dhe orari i shërbimit: Objekti që do të sigurohet është: "Ruajtja e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Adresa ish UMB Korce

1.Sherbimi do të kryet, me 1 vend-roje nga hene-premte (në ditë pune) ora 15:00 - 07:00, ditët e pushimit dhe festa zyrtare 24 ore me 4 punonjës shërbimi.

2.Rojët duhet të jenë të paisur me uniforme pa ta cilën nuk pranohen në shërbim si dhe mjet identifikimi me fotografi [...]."

Në termat e referencës është parashikuar:

Objekti që do të ruhet dhe orari i shërbimit : Objekti që do të sigurohet është: "Ruajtja Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Adresa ish UMB Korce".

1- Sherbimi do të kryet, me 1 vend-roje nga hene-premte (në ditë pune) ora 15:00 - 07:00, ditët e pushimit dhe festa zyrtare 24 ore me 4 punonjës shërbimi.

III.1.4. Në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik "Dea Security" sh.p.k, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit në SPE, si vijon:

1,Ishte : Fondi i Marrveshjes Kuader për nga data 03.03.2018 deri me datën 31.12.2018 për 304 ditë 1,929.605,52 (njemilion e nentëqind e njëzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesë mijë e pesëqind e shtatë) lekë pa TVSH. Fondi limit për një vendroje/një muaj- 6.347,38 (gjashtë

mije e treqindedyzeteeshteteleke e tridhjetë e tete lekë pa TVSH, Burimi i Financimit : Të ardhurat e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër : Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat nga data 03.03.2018 deri me datën 31.12.2018 për 304 ditë

Nga dita e hënë deri të premte -orari i shërbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).

Te shtunë - orari i shërbimit 24 ore

Ditën e diel orari i shërbimit 24 ore

Dite festa zyrtare orari i shërbimit 24 ore

-Turni i dytë nga ora 19.00 – 22.00

-Turni i tretë nga ora 22.00- 6.00 (ditë e nesërme)

1.1 Behet Fondi i Marrëveshjes Kuader për nga data 03.03.2018 deri me datën 31.12.2018 për 304 ditë 1,929.605,52 (njemilion e nentëqind e njëzetëenente mijë e gjashtëqindpese mijë e pezjetedy) lekë pa TVSH Fondi limit për një vendroje/një muaj- 6.347,38 (gjashtë mijë e treqindedyzeteeshteteleke e tridhjetë etetelekë pa TVSH Burimi i Financimit : Të ardhurat e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër : Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat nga data 03.03.2018 deri me datën 31.12.2018 për 304 ditë

- Nga dita e hënë deri të shtunë -orari i shërbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).
- Ditët e diela orari i shërbimit 24 ore
- Marrëveshjes Kuader 1,929.605,52 (njemilion e nentëqind e njëzetëenente mijë e gjashtëqindpese mijë e pezjetedy) lekë pa TVSH
- Fondi limit për një vendroje/një ditë- 6.347,38 (gjashtë mijë e treqindedyzeteeshteteleke e tridhjetë etetelekë pa TVSH
- **Me nr rojesh për vendroje 3,7 roje**
- Me afat nga data 03.03.2018 deri me datën 31.12.2018
- Për 304 ditë
- Për 1 vendroje

III.1.5 Në VKM-në nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” ku shprehimisht përcaktohet: “[..] Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale, orare, të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë.[..]”

III.1.6. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

III.1.7. Referuar “Kodit të Punës” e më konkretisht:

Neni 81 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Shtesa mbi pagë ”

“Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50%”,

Neni 82 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Koha javore e punës”

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 2400. Në nenin 83 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: « Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës ”.

Neni 85 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimi javor”

- 1) Pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë pa ndërprerje.
- 2) Pushimi javor përfshin ditën e diel.
- 3) Pushimi javor nuk është i pagueshëm.
- 4) Përgjashtimet rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 86 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Ditët e festave zyrtare”

- 1) Si rregull ndalohej puna në ditët e festave zyrtare.
- 2) Punëmarrësi gëzon të drejtën e pagës në ditët e festave zyrtare.
Kur dita e festës zyrtare bie në ditët e pushimit javor, pushimi shtyhet ditën e hënë.
- 3) Përgjashtimet për të punuar në ditët e festave zyrtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave ose në kontratën kolektive.

Në nenin 87, po këtij, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.”;

Neni 92 i “Kodit të Punës”, parashikon: “Pushimet vjetore/Kohëzgjatja”

- 1) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës.
- 2) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim.
- 3) Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paafësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune.

III.1.8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.1.9. Në nenin 59, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’ireferohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga

institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

- çmimet e tregut;ose/dhe
- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe
- çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet."

III.1.10. Në Rekomandimin e APP-së dhe KPP-së të datës 20.12.2017, protokolluar nga APP-ja me nr. 15/66 prot., datë 20.12.2017, dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me nr. 1858 prot., datë 20.12.2017, në pikën 1 të tij parashikohet shprehimisht se: "[...]Për shërbimin 24 orë pa ndërprerje (nga e hëna në të dielë), numri i rojeve për vendroje duhet të llogaritet me koeficientin e zëvendësimit 1.66 punojës për turn".

III.1.11. KPP sqaron se Autoriteti Kontraktor, në përputhje me dispozitat e ligjit për prokurimin publik dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, hartimin dhe miratimin e buxhetit, mirëpërdorimin e fondeve dhe menaxhimin e procedurave të prokurimit publik, përgjegjës direkt për përllogaritjen e fondit limit dhe argumentimin e tij. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nisur nga shërbimi i ruajtjes me 4 roje në një vendroje sic është përshkruar në termat e referencës dhe shërbimet e grafikun e ekzekutimit të dokumentave të tenderit si më sipër cituar, vlera limit e kontratës nuk është përllogaritur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të sipërpërmendura, duke sjellë pamjaftueshmërinë për kryerjen e shërbimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në ndryshimin e dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka ulur numrin e rojeve në vendroje nga 4 punonjës në 3.7 punonjës shërbimi, ndryshim i cili nuk rezulton të jetë argumentuar nga autoriteti kontraktor, për më tepër që ankimesi nuk e ka kontestuar numrin e rojeve të nevojshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Për më tepër sqarojmë se ulja e numrit të rojeve nuk është bërë në përputhje me udhëzimin e perbashkët midis APP-së dhe KPP-së si më sipër cituar, referuar koeficientit të zëvendësimit 1.66.

III.1.12. Bazuar ne nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese." Në nenin 24, pika 1 "Anulimi i një procedure prokurimi" gërma "dh" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) Kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji."

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për shkak se fondi limit është i pamjaftueshëm për kryerjen e shërbimit, procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Për rrjedhojë pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar afatin “nga data 03.03.2018 deri në datën 31.12.2018 për 304 ditë”, ndërkohë tek shtojca 11 “Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhjes së kontratës 10 muaj”. Pra në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka dhënë dy afate të ndryshme; një herë 10 muaj që i takojnë 306 ditë, dhe një herë 304 ditë. Kërkojmë nga autoriteti kontraktor të saktësojë afatin e dhënë në dokumentat e tenderit në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. AK në përgjigje është shprehur për 304 ditë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, të dokumentave të tenderit, është parashikuar:

Afatet e ekzekutimit:

Objekti që do të ruhet dhe orari i shërbimit: Objekti që do të sigurohet është:

Ruajtja Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Adresa ish UMB Korçe

1- Shërbimi do të kryet, me 1 vend-roje nga hene-premte (në ditë pune) ora 15:00 - 07:00, ditet e pushimit dhe festa zyrtare 24 ore me 4 punonjes shërbimi

Afatet e ekzekutimit: Nga momenti i lidhjes së kontratës 10 muaj

III.2.2. Në Njoftimin e kontratës, Seksioni 2 “Objekti i kontratës”, pika 2.3 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:”, të dokumentave të tenderit të publikuar nga ana e autoritetit kontraktor në datën 10.01.2018, thuhet:

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 304 ditë ose duke filluar nga 03.03.2018 me përfundim 31.12.2018

III.2.3. Në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k, lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit në SPE, si vijon:

1.Ishte : Fondi i Marrveshjes Kuader per nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite 1,929.605,52 (njemilion e nenteqind e njezet e nente mije e gjashteqind e pese mije e pesedhjetë e dy) lekë pa TVSH. Fondi limit per nje vendroje/nje muaj- 6.347,38 (gjashte mije e treqindedyzeteeshteteleke e tridhjetë e tete lekë pa TVSH, Burimi i Financimit : Të ardhurat e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër : Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite

Nga dita e hene deri te premte -orari i shërbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).

Te shtune - orari i shërbimit 24 ore

Diten e diel orari i shërbimit 24 ore

Dite festa zyrtare orari i shërbimit 24 ore

-Turni i dytë nga ora 19.00 – 22.00

-Turni i tretë nga ora 22.00- 6.00 (ditë e nesërme)

1.1 Behet *Fondi i Marrveshjes Kuader per nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite 1,929.605,52 (njemilion e nenteqind e njezet e nente mije e gjashteqind e pese mije e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH. Fondi limit per nje vendroje/nje muaj- 6.347,38 (gjashte mije e treqind e dyzet e shtate leke e tridhjetë e tete lekë pa TVSH. Burimi i Financimit: Të ardhurat e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjenteve rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018 per 304 dite*

- *Nga dita e hene deri te shtune -orari i shërbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).*
- *Ditet e diela orari i shërbimit 24 ore*
- *Marrveshjes Kuader 1,929.605,52 (njemilion e nenteqind e njezeteenente mije e gjashteqindepese mije e pezjeteedy) lekë pa TVSH*
- *Fondi limit per nje vendroje/nje dite - 6.347,38 (gjashte mije e treqind e dyzet e shtate leke e tridhjetë e tete lekë pa TVSH.*
- *Me nr rojesh per vendroje 3,7 roje*
- *Me afat nga data 03.03.2018 deri me daten 31.12.2018*
- *Per 304 dite*
- *Për 1 vendroje*

III.2.4. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe 4 përcaktohet se “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, është parashikuar: “Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

III.2.6. Në Dokumentat Standarte të Tenderit, pika II, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1, thuhet: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.2.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor, në përgjigjen e kthyer ankimesit si më sipër cituar, si dhe në shtojcën e publikuar në SPE, sqarohet se periudha e kryerjes së shërbimit është përcaktuar 304 ditë (03.03.2018-31.12.2018), duke saktësuar përfundimisht afatin e zbatimit të kontratës.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, sipas kthimit të përgjigjes dhe sqarimit të bërë nëpërmjet shtojcës së publikuar në SPE, duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit duke unifikuar afatin e ekzekutimit të kontratës në DST.

Pretendimi i ankimesit “Dea Security” sh.p.k qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k se: “Në dokumentat e tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar tek shtojca 1 se bashkëngjitur formularit të cmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje në 2 vendroje në muaj, sipas tabelës së mëposhtme, ndërkohë tek shtojca 9, autoriteti kontraktor përcakton se: 1. Shërbimi do të kryhet me një vendroje nga hënë-premte (në ditë pune) ora 15:00-07:00, ditët e pushimit dhe festa zyrtare 24 orë me 4 punonjës shërbimi. Kërkojmë të saktësohet numri i vendrojeve dhe numri i rojeve në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së. Autoriteti kontraktor në përgjigje është shprehur për një vendroje”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, pjesë e dokumentave të tenderit të publikuara në datën 10.01.2018 nga autoriteti kontraktor, është parashikuar:

- 3.[...] Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me licensat, uniformat, paisjen me arme dhe radiomarres, pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
4. Bashkelidhur formularit te cmimit te ofertes te paraqitet **preventivi per nje roje dhe 2 vend-roje në muaj**, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e **kostos mujore** të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /muaj
1	Shpenzime për pagë bazë	
2	Shtesë mbi pagë për turnin II	
3	Shtesë mbi pagë për turnin III	
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%	
5	Tarifa për taksë armëmbajtje, municione, mirëmbajtje armatimi, etj.sipas akteve nenligjore	
6	Shpenzime për uniformë dhe veshëmbathje	
7	Shpenzime për ndërlidhje	
8	Shpenzime të tjera (administrative, etj.)	
9	Fitimi (%)	
	Vlera totale pa tvsh per 1 muaj	
	Vlera totale me tvsh per 1 muaj	

- Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligji 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”.

- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje te llogaritet (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**. Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Dite mesatare ne muaj (per efekt te llogaritjes se ofertes) **30.41 dite/muaj**
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kosos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore, kostot e armatimit, mirëmbajtjes, municionit, etj.), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Llogaritja e zerave te mos kalojë dy shifrat pas presjes dhjetore.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.3.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” është parashikuar:

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Shërbimi në dy vendroje në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata.

- Nga dita e hene deri te premte -orari i sherbimit nga ora 15.00 – 07.00 (dita e nesërme).
- Te shtune - orari i sherbimit 24 ore
- Diten e diel orari i shërbimit 24 ore
- Dite festa zyrtare orari i shërbimit 24 ore
- -Turni i dytë nga ora 19.00 – 22.00
- -Turni i tretë nga ora 22.00- 6.00 (ditë e nesërme)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

Kërkesat për zbatimin e shërbimit

Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për SHRSF”. Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre.

Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.

Rojet duhet të kenë leje arme.

Rojet e turnit të tretë të jenë të pajisur me armë.

Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:

- a-Rregullorja e brendshme
- b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.
- c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.
- d-Mjete ndriçimi në rast mungese te energjise elektrike.
- e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.
- f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.

Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të tenderit është kërkuar:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Objekti qe do te ruhet dhe orari i sherbimit : Objekti qe do te sigurohet eshte

Ruajtja e Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe Adresa ish UMB Korce

1.Sherbimi do te kryet, me 1 vend-roje nga hene-premte (ne dite pune) ora 15:00 - 07:00, ditet e pushimit dhe festa zyrtare 24 ore me 4 punonjes sherbimi

2.Rojet duhet te jene te paisura me uniforme pa ta cilen nuk pranohen ne sherbim si dhe mjet identifikimi me fotografi.

3.Rojet duhet te kene shenjen dalluese te shoqerise sipermarrese.

4.Organizon ruajtjen dhe sigurine ne postin e sherbimit, ruan, mbikqyr dhe kontrollon gjithë territorin

5.Ne vendroje me sherbim te diferencuar, jo te vazhdueshem,me mbarimin e ndrreses,roja ia dorezon sherbimin personit te ngarkuar nga drejtuesi i sherbimit te kesaj vendroje, sipas rastit pergjegjesit te administrates dhe personave te caktuar prej tij.

6.Rojet mbikqyrin zbatimin e rregullit te brendshem dhe nuk lejojne hyrjen e personave te jashtem, pa autorizimin perkates(leje) leshuar nga personi kopetent.

7.Roja ne sherbim ndalon rreptesisht (dhe forcerisht) futjen dhe nxjerrjen ne/dhe nga objekti te materialeve, mallrave, aparaturave, paisjeve etj.,pa dokumentin perkates sic mund te jete, fletehyrje, fletedalje ,urdher punimi etj.,ne te cilin caktohet personi i ngarkuar dhe te jete firmosur nga personi i autorizuar.

8.Roja parandalon dhe merr masa(kur ndodhin) per evidentimin e rasteve flagrante,kur nga persona te jashtem ose te brendshem ka raste te prishjes se rendit ose kur cenohet integriteti i personelit .

9.Roja parandalon dhe merr masa(kur ndodhin) per evidentimin e rasteve flagrante,kur nga persona te jashtem ose te brendshem ka raste te prishjes se rendit ose kur cenohet integriteti i personelit .

III.3.3. Në Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe 4 përcaktohet se “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 1, është parashikuar: “Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.”

III.3.5. Në Dokumentat Standarde të Tenderit, pika II, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës”, pika 1.1, thuhet: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar dy shtojca lishur me specifikimet teknike dhe konkretisht, shtojcën 8 dhe shtojcën 9. Nga shqyrtimi i këtyre shtojcave rezulton se informacioni, që ato përmbajnë, është kontradiktor, pasi në specifikimet teknike, sipas shtojcës 8, është parashikuar kryerja e shërbimit të ruajtjes me roje në dy vendroje ndërsa sipas shtojcës 9 ky shërbim do të kryhet në 1 vendroje. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se mospërcaktimi i saktë i informacionit në lidhje me numrin e vendrojeve, krijon konfuzion tek ofertuesit për

përgatitjen e ofertave të tyre ekonomike. Duke patur parasysh faktin që dokumentat e tenderit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për natyrën dhe përbërësit e shërbimit të ruajtjes me roje, (pra të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë kryrjen e shërbimit të kërkuar), mosvendosja e saktë e informacionit mbi numrin e vëndrojeve pengon konkurrencën e drejtë në prokurimin publik, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e dokumentave të tenderit, duke përcaktuar saktë numrin e vëndrojeve të kërkuara në mënyrë që të mos krijohet asnjë keqkuptim nga ana e operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit “Dea Security” sh.p.k qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Kërkojmë të hiqet kriteri: “Autoriteti kontraktor para se të nxjerrë vlerësimin, do të bëjë verifikimin e Qendrës së Kontrollit, sipas elementëve përbërës të Udhëzimit MB nr. 157, datë 01.04.2015 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, për cdo operator ekonomik pjesëmarrës në tender. Mungesa e njërit prej tyre është kusht skualifikues.” Kërkojmë të hiqet kriteri pasi për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për më tepër për funksionimin e qendrës së kontrollit, ka një organ përgjegjës që është Drejtoria Vendore e Policisë Korcë e cila gëzon të gjitha kapacitetet dhe aftësitë për të vlerësuar përmbushjen e dispozitave ligjore dhe jo autoriteti kontraktor. Autoriteti mund të kërkojë dokument të përcaktuar specifikisht që lëshohet nga DVP e cila certifikon qendrën e kontrollit të SHPSF, duke e pasqyruar atë në vërtetimin e performancës dhe aktin e miratimit të shoqërisë [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 3.1 “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

“Autoriteti Kontraktor para se të nxjerrë vlerësimin do të bëjë verifikimin e Qendrës së Kontrollit, sipas elementeve përbërëse të Udhëzimit MB nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike”, për cdo Operator Ekonomik pjesëmarrës në tender, mungesa e njërit prej tyre është kusht skualifikues.”

Gjithashtu në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 7 dhe 8, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim performancë lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korce, konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Ky vërtim duhet të jetë jo me vone se tre muaj nga data e hapjes së ofertave dhe të përmbajë informacionin që disponon Drejtoria Vendore e Policisë Korce:

a). Qendra e kontrollit të Shërbimeve, (salla operative).

b). Numrin e objekteve në ruajtje

c). Numrin e punonjësve të licensuar nga DVP Korce për kategorinë 1.3A, bashkëngjitur listën e të konfirmuar përkatëse.

- d) Numrin e punonjesve te sherbimit per kategorine 1.3A Per ruajtje objekti, N/kategoria 1.3.A per 5 (pese) punonjes sherbimi ruajtje objekti
- e). Numrin e punonjesve te Qendres kontrollit jo me pak se 4 (kater) punonjes sherbimi.
- f). Numrin e armeve te brezit jo me pak se 2 (dy) ne vendsherbim per 4(kater) punonjes sherbimi.
- g). Numrin e punonjesve te pajisur me autorizim per mbajtje arme jo me pak se 4(kater)
- gj)Lejet e Ushtrimit Profesionit/Çertifikatat e punonjesve te sherbimit, sipas Ligjit nr. 75/2014, "Për shpsf-te" per jo me pak se 4(kater) punonjes, te leshuara nga Drejtoria Vendore e Policise Korçë.
- e). Te kete Grup te gatshem per perballimin e situatave emergjence qe do te nevojiten per mbarevajtjen e sigurimit te objekteve te DRSHTRR Korçë
- i).Te mos kete mare mase administrative dhe ngjarje per vitin 2016 dhe 2017

8. Akti miratimi per qendren e kontrollit te ShPSF (24 oreshe) konform ligjit nr.75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike" leshuar nga Drejtoria Vendore e Policise Korce, shoqeruar me proces verbalin e miratimit.

III.4.2. Në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik "Dea Security" sh.p.k, lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit në SPE, si vijon:

Ishte Ne dokumentat e tenderit ishte: (KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT),Pikat 1,2,3.

Autoriteti Kontraktor para se te nxjerre vleresimin do te beje verifikimin e Qendres Kontrollit, sipas elementeve perberes te Udhezimit MB nr.157 date 01.04.2015 "Per Funksionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike", per cdo Operator Ekonomik pjesmares ne tender,mungesa e njerit prej tyre eshte kusht skualifikues.

Bëhet: Autoriteti Kontraktor para se te nxjerre vleresimin ka per detyre te beje verifikimin e Qendres Kontrollit, sipas elementeve perberes te Ligjit 75/ 2014''Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike'',Neni 22,Pika 3''Qendra e Kontrollit duhet te jete e pajisur me mjetet e nderlidhjes,komunikimit e vezhgimit dhe te veproje 24 ore ne dite'', per cdo Operator Ekonomik pjesmares ne tender, mungesa e njerit prej tyre eshte kusht skualifikues,...

III.4.3. Në nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese." aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...

III.4.4. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 22 “Qendra e kontrollit të SHPSF-së”, pika 1 është përcaktuar: *“Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë.*

Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.5. Duke qënë se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, në funksion të këtij qëllimi Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për verifikimin e qendres së kontrollit, sipas elementeve të saktësuar në shtojën me ndryshimet e dokumentave të tenderit, të publikuara në SPE si më sipër cituar është një kërkesë e drejtë dhe që nuk shmang konkurrencën në këtë procedurë. Gjithashtu, përsa i përket kërkesës për verifikimin e ekzistencës së qendrës së kontrollit, kjo është një e drejtë e autoritetit kontraktor, e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, për përzgjedhjen e ofertës më të mirë me kosto sa më të ulët.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Autoriteti kontraktor ka kërkuar tek kapaciteti ekonomik e financiar: “Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2014, 2015, 2016 për cdo vend të ushtrimit të aktivitetit për Nipt dytësor. Duke qënë se taksat vendore paguhen në fillim të vitit, nga*

ana e autoritetit kontraktor duhet të kërkojnë vitet 2015, 2016, 2017 dhe jo viti 2014, i cili duke qenë se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen mesues të kontratës, në rastin konkret e bën këtë një kriter të ekzagjeuar dhe joproporcional me natyrën, objektin dhe përmasat e kontratës së shërbimit në fjalë, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik e financiar”, gërma “e” e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE në datën 10.01.2018, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

“Operatori ekonomik të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2014, 2015, 2016 për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit per Nipt dytesor . (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore).”

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

III.5.3. Në nenin 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2 të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.5.4. Në nenin 15 pika 4, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar parashikohet se; “Pagesat e kësteve të tatimit kryhen te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare për llogari të administratës tatimore, brenda datave 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të çdo viti”.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetet e tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë,

përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e një dokumenti, përmes të cilës vërtetohet se subjekti ka paguar taksat dhe tarifatat lokale për vitet 2014, 2015 dhe 2016 nuk është një kriter në proporcion me natyrën, objektin e kontratës, në kushtet kur informacioni që merret për pagimin e taksave vendore për vitin 2014 është shumë i hershëm. Ndërkohë bazuar në legjislacionin në fuqi si më sipër cituar, operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të kenë shlyer të gjitha pagesat për taksat vendore për vitin 2017 brenda datës 20 dhjetor 2017. Autoriteti kontraktor nuk mund të përcaktojë si kriter kualifikues shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për tre vitet e fundit, duke përfshirë vitin 2017, i cili ka përfunduar dhe, sipas legjislacionit përkatës, duhet të jenë shlyer detyrimet për këtë vit.

Pra sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë kriteret, referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, që përfshijnë tre vitet e fundit financiare, gjithmonë kur ky informacion është i mundur, pra në rastin konkret, duhet të konsiderojë si periudhën e fundit financiare 3 vjeçare edhe vitin 2017, duke përfshirë vitin 2014.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin përkatës të këtij kriteri duke shtuar kërkesën për vitin 2017 dhe duke hequr kërkesën për vitin 2014.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.6. Lidhur me pretenimin e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k se: *“Autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë akt pronësie/kontratë qiraje për qendrën e kontrollit/sallës operative. Kontrata e qirasë të jetë me afat jo më pak se 12 muaj nga data e hapjes së ofertave.”*

Kërkojmë nga AK të heqë këtë kriter pasi [...] nuk i shërben autoritetit kontraktor për verifikimin e kapacitetit teknik për qendrën e kontrollit, [...] është një kriter diskriminues, në kundërshtim me frymën e LPP-së”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 6, është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë akt pronësie/kontratë qiraje për qendrën e kontrollit/sallës operative. Kontrata e qirasë të jetë me afat jo më pak se 12 muaj nga data e hapjes së ofertave.”

III.6.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, rashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit*

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë përmasat e kontratës, që do të prokurohet, sic është përcaktuar edhe në rregullat e prokurimit publik.

III.6.4. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të pronësisë apo kontratat e qirasë për ambjentet e sallës operative, është një kriter i ekzagjeruar, i cili nuk i shërben autoritetit kontraktor për verifikimin e kapacitetit teknik për qendrën e kontrollit. Dokumentacioni, që shërben për verifikimin e këtij kapaciteti, janë dokumentat e dala nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të tilla si Akti i Miratimit, Vërtetimi i performancës, të cilat i japin mundësi autoritetit kontraktor të verifikojë këtë kapacitet në cdo moment. Qëllimi i vendosjes së kriterit nga ana e autoritetit kontraktor bëhet për të krijuar bindjen e këtij të fundit se operatorët ekonomikë disponojnë qendër kontrolli.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit sipas konstatimeve më lart.

Sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k se: *“Autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim përformance, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë....Numrin e punonjësve të pajisur me autorizim për mbajtje arme jo më pak se 4.” Kërkojmë heqjen e kërkesës për autorizim për mbajtje arme jo më pak se 4 pasi [...] legjislacioni në fuqi për armët lejon dhe i jep të drejtën e blerjes së armës cdo personi fizik apo juridik përfshirë këtu edhe cdo operator ekonomik [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 7, gërma “e” e dokumentave të tenderit, është kërkuar si vijon:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim përformance lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij. Ky vërtetim duhet të jetë jo më vonë se tre muaj nga data e hapjes ofertave dhe të përmbajë informacionin që disponon Drejtoria Vendore e Policisë Korçë:

g). Numrin e punonjësve të pajisur me autorizim për mbajtje arme jo më pak se 4(kater).”

III.7.2. Referuar ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, në nenin 34, parashikohet shprehimisht:

1. Në veprimtarinë e sigurisë fizike, të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit.

2. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

III.7.3. Referuar ligjit 74/2014, datë 10.07.2014 “Për armët”, neni 5 “Kategorizimi i armëve” parashikon shprehimisht se: “1. Armët, sipas këtij ligji, kategorizohen si më poshtë:

1.2. Armët e kategorisë “B” janë:

a) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautematike apo vetërimbushëse (B1);

b) armët e zjarrit të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore (B2);

c) armët me ndezje anësore të shkurtra për një qitje, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28cm; (B3);

ç) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të mbajnë më tepër se tre fishekë (B4);

d) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike, me gushë ose fole për fishekë, që mund të pranojnë deri në tre fishekë. Kur mbushësi i tyre ndërrohet, këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe të pranojnë më tepër se tre fishekë (B5);

dh) armët e zjarrit të gjata gjysmautematike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 cm (B6);

e) armët e zjarrit pneumatike, me energji të predhës mbi 7,5 J dhe kalibër mbi 4,5 mm (B7); [...];”

Gjithashtu, në nenin 7 “E drejta e pronësisë mbi armët”, të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht se:

“1. Armët e kategorisë “A”, në kuptim të këtij ligji, janë vetëm pronë e shtetit, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska dhe të pajisura me shënjestër optike.

2. Armët e kategorive “B”, “C” dhe “D”, në kuptim të këtij ligji, mund të jenë në pronësi private e shtetërore.

3. Veprimet juridike për kalimin e pronësisë ose të të drejtave të tjera mbi armët kryhen në përputhje me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Për sa nuk parashikohet në këtë ligj, zbatohen dispozitat e Kodit Civil.”

Ndërsa neni 8 i ligjit “Regjimi juridik për kategoritë e armëve” përcaktohet se: “[...] Për armët e përcaktuara në nenin 5, të këtij ligji, ka regjim të veçantë juridik ,duke respektuar përfshirjen në kategoritë e ndryshme, si më poshtë:

1. Në kategorinë “A” përfshihen armë, të cilat nuk lejohen të përdoren dhe për të cilat nuk lëshohet autorizim, me përjashtim të armëve të zjarrit të gjuetisë dhe ato sportive me vjaska, të pajisura me shënjestër optike, që në kuptim të këtij ligji nuk janë të ndaluara. Për këto armë, pajisen me autorizim nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit, ata shtetas shqiptarë ose të huaj që vërtetojnë aftësinë e ushtrimit të sportit të qitjes profesionale ose gjuetisë, sipas vërtetimit/lejes përkatëse nga ministria përgjegjëse për sportet ose ajo për mjedisin.

2. Në kategorinë “B” përfshihen armë, për të cilat lëshohet autorizim sipas këtij rregulli:

a) për armët e kategorisë “B1”, pajisen me autorizim personat që për shkak të detyrës shtetërore ose të rrethanave personale të veçanta janë të ekspozuar ndaj rrezikut për jetën dhe u njihet e drejta e mbrojtjes së veçantë, sipas legjislacionit në fuqi, personat që plotësojnë kriteret për mbajtjen e armës, si dhe ata të cilëve për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas këtij ligji;

- b) për armët e kategorisë "B4", pajisen me autorizim personat që për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së sigurisë private, u lind e drejta e mbajtjes së armës, sipas dispozitave të këtij ligji.
[...].”

III.7.4. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.7.5. Referuar bazës ligjore sa më sipër përcaktohet qartë se çdo person i pajisur me certifikatën si punonjës shërbimi për ruajtjen dhe sigurinë fizike, ka të drejtën për përdorimin edhe të armës së zjarrit. Në këtë kontekst, çdo person i pajisur me leje/certifikatën si punonjës shërbimi, ka të drejtë për përdorimin e armës së zjarrit. Komisioni gjykon se kriteret lidhur me armatimin duhet të hartohen nga autoriteti kontraktor duke mbajtur në vëmendje legjislacionin mbi armët që i japin të drejtën, cdo operatori ekonomik që ushtron aktivitet në fushën e shërbimit të sigurisë së ruajtjes fizike, të pajisjen me armatim personal sipas ligjit, duke dëshmuar në procedurat prokuruese plotësimin e kapaciteteve lidhur me armatimin. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar, duke hequr kriterit lidhur me autorizimin/leje për mbajtje arme.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k se: “Autoriteti kontraktor ka kërkuar: “Akt miratimi për qendrën e kontrollit të ShPSF (24 orëshe) konform ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, shoqëruar me procesverbalin e miratimit. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri pasi [...] kërkesa për qendër kontrolli duhet të konsiderohet e përmbushur me paraqitjen e Akt miratimit të saj nga Drejtoria e Policisë së Qarkut. Autoriteti kontraktor duhet të heqë kriterin “shoqëruar me procesverbal” [...].”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën 6 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 8, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

8. Akti miratimi për qendrën e kontrollit të ShPSF (24 orëshe) konform ligjit nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, shoqëruar me procesverbalin e miratimit.

III.8.2. Neni 22 i Ligjit Nr.75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” parashikon shprehimisht se: 1. Subjekti i licencuar për aktivitetin e shërbimit privat të sigurisë fizike, në çdo njësi administrative që ushtron veprimtari, duhet të ketë qendër kontrolli, ku të tregohet adresa e saj fizike dhe elektronike, si dhe stema me emërtimin e shoqërisë. 2. Qendra e kontrollit të shërbimit kryen detyrat e drejtimit, mbikëqyrjes dhe menaxhimit të veprimtarisë

së sigurisë fizike. 3. Qendra e kontrollit duhet të jetë e pajisur me mjetet e ndërlidhjes, komunikimit e vëzhgimit dhe të veprojë 24 orë në ditë.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit duhet të mbajë parasysh parashikimet ligjore në funksion të aritjes së qëllimit për krijimin e bindjes së tij lidhur me kapacitetet ekonomikë, profesionale, teknike të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteri sa më sipër lidhur me disponueshmërinë e qendrës së kontrollit nga ana e operatorëve ekonomikë duhet të konsiderohet i përmbushur nga autoriteti kontraktor me paraqitjen e Akt Miratimit të Qendrës së Kontrollit dhe vërtetimin e performancës lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut. Cdo dokumentacion shtesë, përfshirë procesverbal, kërkesa, apo akte të ndërmjetme të administruara apo prodhuara nga organi kompetent të cilat kanë cuar në nxjerrjen e aktit final pra të "Akt Miratimit" nuk duhet të përbëjnë objekt kërkimi nga autoriteti kontraktor pasi kërkesa të tilla të panevojshme për dokumenta shtesë vecse pengojnë dhe vështirësojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron

III.9. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Dea Security" sh.p.k se: "Autoriteti kontraktor ka kërkuar: "Faturën e magazinës SIMA (Sistemi i Informatizuar i Menaxhimit të Armëve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë". Kërkojmë heqjen e kriterëve të cilat kufizojnë pjesëmarrjen, janë diskriminuese dhe bien në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi, sipas legjislacionit për armët për të treguar pronësinë e armëve është e mjaftueshme paraqitja e autorizimit për bleje arme nga policia, kontratë blerje dhe faturat tatimore. Gjithashtu sqarojmë se faturën e SIMA e lëshon Drejtoria e Policisë Tiranë dhe më pas bëhet shpërndarja e armëve të regjistruara në DVP përkatëse. Pra kërkesa për faturën e magazinës SIMA të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë është diskriminuese dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.9.1. Në "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 11, është kërkuar:

"11 .Dokumentacioni i armes ne zoterim:

- Autorizimin nga Drejtoria e Pergjitheshme e Policise se Shtetit per blerje arme
- Kontraten e blerjes se armes
- Faturen tatimore te blerjes
- **Faturen e magazines SIMA (Sistemi Informatizuar i Menaxhimit te Armeve) te Drejtorise Vendore te Policise Korce.**
- Autorizime per mbajtjen e armes per 5 punonjes."

III.9.2. Në nenin 46 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me

natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.9.3. Referuar ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, në nenin 34, parashikohet shprehimisht:

1. Në veprimtarinë e sigurisë fizike, të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit dhe municionit, vetëm gjatë kryerjes së detyrës, e kanë drejtuesi teknik dhe punonjësit e shërbimit.

2. Lloji i armëve të zjarrit dhe municionit të tyre që jepen për mbajtje miratohen nga Policia e Shtetit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

III.9.4. Neni 28, pika 5, gërma “ç” e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.9.5. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se:

2. Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.9.6. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor për paraqitjen e faturës së magazinës SIMA (Sistemi Informatizuar i Menaxhimit të Armeve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korce, është një kërkesë e ekzagjeruar që

dekurajon operatorët ekonomikë të paraqesin oferta në procedurën e mësipërme të prokurimit. Sqarojme se dokumentacioni mbi disponimin e armëve sic është autorizimi për blerje arme nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit, si dhe kontrata e blerjes së armës dhe fatura tatimore e blerjes së armës, përbëjnë dokumentacion të mjaftueshëm për të vërtetuar disponimin e armëve nga ana e operatorëve ekonomikë. Në rast se autoriteti kontraktor ka dyshime lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit përsa i përket armatimit, mbështetur në rregullat e prokurimit publik mund të bëjë verifikimet përkatëse pranë organeve kompetente, sic është Drejtoria e Policisë së Qarkut, e cila ndjek dhe monitoron aktivitetin e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr.REF-39998-01-09-2018 me objekt: “Ruajtja e godinave të Sh-A .T.Sh.F.P.Korçe dhe ambjentete rrethues së saj brenda murit rrethues me roje private”, me fond limit 1.929.605,52 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.01.2018 nga autoriteti kontraktor Tregu i Shitjes me Shumice Fruta - Perime Korçë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit.
3. Me rishpalljen e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k .
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 97 Protokolli,

Datë 23.01.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha